



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. 20/DPK
Nr. i faq. Broj stranica
Nr. pages 02

Nr Prot Br Prot
Prot No 01-637/14
Data
Data 20-02-2014
PRISHTINE

DATË/A:	19.02.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Ymer DRAGUSHA Drejtor i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit në Korporatën Energjetike të Kosovës Sh.a
CC:	z. Arben GJUKAJ Drejtor Menaxhues në Korporatën Energjetike të Kosovës Sh.a
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Shërbimet e sigurimit shëndetësor për punëtorët e KEK sh.a"



I nderuari, z. Dragusha ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Shërbimet e sigurimit shëndetësor për punëtorët e KEK sh.a" me nr. të prokurimit: KEK-S 14 023 211, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Shërbimet e sigurimit shëndetësor për punëtorët e KEK sh.a" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra Ekzekutive e Prokurimit (ZEP) pranë Korporatës Energjetike të Kosovës ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull “Shërbimet e sigurimit shëndetësor për punëtorët e KEK sh.a” me nr. të Prokurimit: KEK-S14023211, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.24.01.2014, në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të këtij aktiviteti të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në “Njoftimin për Kontratë” të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 24.01.2014, tek rubrika III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar është kërkuar Qarkullimi minimal në 2 vitet e fundit dhe atë për secilin vit minimum **1.500.000,00€ (për dy vitet 3,000.000.00 €)**, pikë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional” të “Njoftimit për Kontratë” është kërkuar Dëshmi mbi sigurimin jo me pak se **2000 personave** gjatë vitit 2012 dhe/apo 2013, pikë kjo për të cilën, gjithashtu konsiderojmë se bie ndesh me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik. Të njëjtat kërkesa të cilat i ka kërkuar A.K. në “Njoftimin për Kontratë” janë përshkruar edhe në “Dosjen e Tenderit” .

Autoriteti Kontraktues me kriterin e shumës së Qarkullimit financiar dhe kërkesën mbi sigurimin e jo më pak se 2000 personave, bënë që disa Operatorët Ekonomik të mos jenë në gjendje të konkurrojnë dhe të jenë pjesë e konkurrencës së lirë dhe të ndershme. Kriteret e tilla diskriminojnë disa Operator Ekonomik, dhe në të njëjtën kohë mund të favorizojnë Operator të caktuar Ekonomik. Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, autoriteti kontraktues duhet ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të operatorëve ekonomik të rinj dhe të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë të tillë që nuk përjashton operatorët ekonomik të rinj të cilët posedojnë në një shkallë të kënaqshme mundësitë ekonomike, financiare dhe/ose teknike.

Kriteret e lartë cekura të rubrikës “Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare” dhe “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale” siç janë përshkruar në “Njoftimin për Kontratë” dhe “Dosjen e Tenderit” janë kritere diskriminuese dhe në këtë mënyrë eliminojnë konkurrencën e lirë dhe favorizojnë Operatorët Ekonomik të caktuar.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin 8 Kriteret e Përzgjedhjes të Rregullores për Prokurimin Publik dhe, nenin 5 Gjendja ekonomike dhe Financiare e udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!